Pasqyrat Financiare te Konsoliduara

dhe Raporti Audituesit te Pavarur

TOP CHANNEL SH.A

31 Dhjetor 2011

TOP CHANNEL sh.a.

Permbajtja

	Faqe
Raporti Audituesit te Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese	4
Pasqyra e ndryshimeve te kapitalit	5
Pasqyra e flukseve monetare	6
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare	7-36

Raporti Audituesit te Pavarur

Per drejtuesit dhe aksioneret e:

TOP CHANNEL SH.A.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te bashkangjitura ketij raporti te TOP CHANNEL sh.a. ("ketej e tutje referuar si "Shoqeria") qe perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2011 dhe pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese, pasqyren e ndryshimeve te kapitalit dhe pasqyren e flukseve monetare per vitin ushtrimor, si dhe nje permbledhje te politikave te rendesishme kontabel dhe shenime te tjera shpjeguese, te paraqitura ne faqet 4 deri 36.

Pergjegjesia e Drejtimit per pasqyrat financiare
Drejtimi eshte pergjegjes per pregatitjen e vertete dhe te sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar, dhe per kontrollet e brendshme qe drejtimi i konsideron te nevojshme per pregatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, qofte nga gabimet apo mashtrimet.

Pergjegjesia e Audituesit
Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Ne kemi kryer auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te perftuar siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidence auditimi ne lidhje me vlerat dhe pohimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i audiuesit, duke perfshire vleresimin e rrezikut te anomalive materiale te pasqyrave financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit. Gjate vleresimit te rrezikut audituesi konsideron kontrollin e brendshem te pershtatshem per pregatitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te Shoqerise me qellim qe te planifikoje procedura auditimi qe jane te pershtatshme me rrethanat, por jo me qellim per te shprehur nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise. Nje auditim gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdorura dhe pershtatshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe vleresimin e pergjithshem te paraqitjes se pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar bazat per opinionin tone te auditimit.

Opinion

Ne opinionin tone, pasqyrat financiare paraqesin, ne te gjitha aspektet materiale ne menyre te drejte, pozicionin financiar te Shoqerise Top Channel sh.a me 31 Dhjetor 2011, si dhe performancen financiare dhe flukset e parase per vitin e mbyllur ne kete date, ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Diana Ylli (Golemi)
Ekspert Kontabel i Rregjistruar

ILD-99 Auditing sh.p.k

Tirane me 30, Mars 2012

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	*Per vitin e mbyllur me* 31.12.2011	*Per vitin e mbyllur me* 31.12.2010 I Reformuar
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	1,239,750,900	896,250,076
Aktivet afatgjata jomateriale	6	47,562	-
Llogari te arketueshme te tjera	7	4,933,700	
		1,244,732,162	**896,250,076**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	8	1,029,177	1,029,177
Llogari te arketueshme tregetare	9	563,489,436	528,307,222
Llogari te arketueshme te tjera	10	27,626,457	31,835,004
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	208,641,627	233,303,629
Mjetet monetare ne arke e ne banke	12	6,639,368	5,054,739
		807,426,066	**799,529,771**
Totali i aktiveve		**2,052,158,227**	**1,695,779,847**
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali aksionar	13	525,400,000	525,400,000
Reduktim i paregjistruar i kapitalit		-	
Rezerva te tjera		72,582,835	57,797,397
Rezerva ligjore		3,335,938	2,557,758
Fitime te mbartura		201,240,936	201,240,935
Fitimi i ushtrimit		17,565,441	15,563,618
		820,125,150	**802,559,708**
Interesat e pakicës ne Kapital		-	-
Totali i kapitalit			
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	14	612,054,991	332,645,186
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	
Grante.te ardhura te shtyra e te tjera detyrime		-	
Detyrime te tjera afatgjata	15	30,168,579	13,886,009
		642,223,570	**346,531,195**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	16	188,365,530	161,974,722
Llogari te pagueshme tregetare	17	344,403,583	354,375,448
Parapagimet e arketueshme	18	32,595,159	4,808,824
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	19	1,891,903	1,678,447
Llogari te pagueshme te tjera	20	22,553,332	23,851,503
		589,809,507	**546,688,944**
Totali i detyrimeve		**1,232,033,077**	**893,220,139**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**2,052,158,227**	**1,695,779,847**

Referoju shenimeve shpjeguese te pasqyrave financiare

Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese

	Shënime	*Per vitin e mbyllur me 31.12.2011*	*Per vitin e mbyllur me 31.12.2010* **I Reformuar**
Te ardhura	21	1,615,077,093	1,398,588,021
Te ardhura te tjera jo operative		-	
Materiale te para dhe te konsumueshme	22	(675,515,053)	(537,252,802)
Shpenzime personeli	23	(601,909,363)	(556,120,947)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	24	(220,935,584)	(219,582,085)
Shpenzime te tjera	25	(48,763,002)	(15,163,165)
Fitimi operativ		**67,954,091**	**70,469,022**
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara	26	(7,136,366)	(27,890,484)
Shpenzime financiare Neto	27	(38,704,450)	(20,731,700)
Total shpenzime financiare		(45,840,816)	(48,622,184)
Fitimi para tatimit		**22,113,275**	**21,846,838**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(4,547,834)	(6,283,219)
Fitimi i vitit		**17,565,441**	**15,563,619**
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse			
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë		**17,565,441**	**15,563,619**

Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 30 Mars 2012 dhe jane nenshkruar ne emer te saj nga administratori,

Z. Enkelejdi Joti
Administrator

Pasqyra e ndryshimeve te kapitalit

	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura/humbje te akumuluara	Interesa te pakicës	Totali
01 Janar 2010	**525,400,000**	**9,200,000**		**252,396,090**		**786,996,090**
Riklasifikim i interesit te pakicës						-
Pakësimi i kapitalit aksionar						-
Shpërndarja e fitimit te vitit 2010						-
Dividendë te paguar						-
Transaksionet me pronaret						-
Fitimi i vitit				15,563,618		15,563,618
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse:						-
Rivlerësime						-
Pakësimi rezervës		48,597,397	2,557,758	(51,155,155)		-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	**525,400,000**	**57,797,397**	**2,557,758**	**216,804,553**	**-**	**802,559,708**
31 Dhjetor 2010						
01 Janar 2011	**525,400,000**	**57,797,397**	**2,557,758**	**216,804,553**	**-**	**802,559,708**
Riklasifikim ndërmjet llogarive te kapitalit						
Shpërndarje nga rezervat statutore		14,785,438	778,181	(15,563,618)	-	-
Transaksionet me pronaret						-
Fitimi i vitit				17,565,442		17,565,442
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse						-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse						-
31 Dhjetor 2011	**525,400,000**	**72,582,835**	**3,335,939**	**234,369,994**	**-**	**820,125,150**

Pasqyra e flukseve monetare

	Shënime	*Per vitin e mbyllur me* **31.12.2011**	*Per vitin e mbyllur me* **31.12.2010**
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		22,113,275	21,846,838
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		135,753,137	152,080,988
Te ardhura nga grante dhe subvencione		85,182,446	
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital			
Pakësimi i rezervave			
Interesa te perllogaritura		777,114	
Shpenzime për interesa			
Diferenca konvertimi te parealizuara		(509,233)	908,034
Tatimi mbi fitimin		4,547,834	(6,283,219)
Tatimi i shtyre mbi fitimin			
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		**247,864,573**	**168,552,641**
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Ndryshimi ne inventar		-	
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera		(37,960,727)	2,889,588
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera		(52,169,511)	(152,396,135)
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra		24,662,002	84,248,510
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative		**(65,468,236)**	**(65,258,037)**
Interesa te paguara			
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit		(6,379,350)	
		(6,379,350)	
Aktivitetet investuese			
Blerje te aktiveve afatgjata material		(480,332,841)	(315,717,073)
Blerje te aktiveve afatgjata jomateriale			
Te hyra nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
Hua dhënë palëve te treta, neto			
Interesa te marra			
		(480,332,841)	**(315,717,073)**
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ te hyrat neto nga kreditë		305,900,483	205,649,766
Te hyra nga grantet qeveritare			
Dividendë paguar			
		305,900,483	**205,649,766**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**1,584,629**	**(6,772,703)**
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	**12**	5,054,739	11,827,442
Mjetet monetare ne fund te periudhës	**12**	**6,639,368**	**5,054,739**

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

1 Informacion i pergjithshem

Top Channel sh.a. ("Shoqeria") eshte nje kompani aksionere eshte krijuar ne vitin 2001 me vendim gjykate Nr. 25561 date 29.03.2001. Veprimtaria e saj sot rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte ne fushen e veprimtarise televizive kombetare qe perfshin prodhimin, transmetimin e programeve te informacionit te cdo lloji me ane te zerit dhe figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikun.

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me dispozitat e ligjit Nr. 8410, datë 30.9.1998 PËR RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (ndryshuar me ligjin nr. 8655 date 31.07.2000, me ligjin nr. 8794 date 10.05.2001, me ligjin nr.9016 date 20.2.2003, me ligjin nr.9124 date 29.07.2003, me ligjin 9531 date 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, date 13.01.2007), me ligjin nr. 8288, datë 18.2.1998 "Për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve", me ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit", ndryshuar me ligjin nr. 7923, datë 19.4.1995, si dhe me dispozitat e tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Pasqyrat financiare jane te konsoliduara duke perfshire Pasqyrat financire Top Channel Tirane dhe Dega Kosove dhe Shkup (Maqedoni).

2 Politikat kontabel

Politikat kryesore kontabel te adoptuara per pregatitjen e ketyre pasqyrave financiare paraqiten si me poshte. Keto politika jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjithe vitet e paraqitura, pervec kur percaktohet ndryshe.

2.1 Bazat e pregatitjes

Pasqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve te publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare ("IFRIC") te IASB.

Pasqyrat financiare jane pregatitur duke perdorur bazat e vleresimit te specifikuara nga SNRF per cdo tip te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes pershkruhen me ne detaj ne politikat kontabel me poshte.

Pregatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon perdorimin e disa cmuarjeve kritike kontabel. Gjithashtu kjo kerkon qe drejtimi te perdore gjykimin e tij ne procesin e perdorimit te politikave kontabel te Shoqerise. Fushat qe perfshijne nje nivel te larte gjykimi apo kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe cmuarjet jane te rendesishme per pasqyrat financiare paraqiten ne shenimin 3: Gjykime, cmuarje dhe supozime te rendesishme kontabel.

2.1 Bazat e pregatitjes (vazhdim)

Pasqyrat financiare jane pregatitur per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011. Te dhenat aktuale ne keto pasqyra financiare jane te shprehura ne Leke. Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitin paraardhes eshte bere riklasifikimi i disa zerave dhe kjo eshte arsyeja e paraqitjes se pozicionit financiar dhe pasqyres se te ardhurave gjithperfshirese te reformuar.

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel

a) Monedhat e huaja

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Zerat e perfshire ne pasqyrat financiare te Shoqerise maten duke perdorur monedhen e mjedisit kryesor ekonomik ne te cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke, e cila eshte monedha e prezantimit te Shoqerise.

Transaksionet dhe balancat

Ne pregatitjen e pasqyrave financiare te Shoqerise, transaksionet ne monedha te ndryshme krahasuar me monedhen funksionale te Shoqerise (monedhat e huaja) rregjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne cdo date te Pasqyres se pozicionit financiar, aktivet dhe detyrimet monetare qe jane ne monedha te huaj perkthehen me kursin e kembimit te dates se Pasqyres se pozicionit financiar. Diferencat nga kembimi njihen ne fitim ose humbje ne periudhen ne te cilen lindin. Aktivet dhe detyrimet jomonetare qe jane njohur me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet ne monedha te huaja dhe qe jane paraqitur me vlere te drejte perkthehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten qe eshte percaktuar vlera e drejte.

Monedhat e huaja me te cilat operon Shoqeria jane Euro dhe USD (dollari amerikan), CHF (franga zvicerane) dhe GBP (paundi britanik). Kursi i kembimit zyrtar i Bankes se Shqiperise (Leku kundrejt njesise se monedhave te huaja) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 eshte si me poshte:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Dollari amerikan (USD)	107.54	104.00
Njesia e monedhes se Bashkimit Europian (Euro)	138.93	138.77
Poundi Britanik (GBP)	165.92	161.46
Franga Zvicerane	114.46	110.98

b) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlere te drejte te shperblimit te mare per sherbimin e kryer, neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

Te ardhurat nga interesat

Interesat njihen ne proporcion me kohen qe reflekton te ardhuren efektive nga aktivi.

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

c) Tatimet

Tatimi mbi fitimin

Aktivi dhe detyrimet per tatimin mbi fitimin per periudhen aktuale maten me shumat e pritura per t'u marre nga apo per t'u paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet per tatimet e perdorura per llogaritjen e vleres se tatim fitimit, jane ato te nxjerra ose te publikuara ne daten e raportimit ne Shqiperi ku Shoqeria operon dhe siguron te ardhura te tatueshme.

Drejtimi vlereson ne menyre periodike pozicionet e ndermarra ne formularet e deklarimit te pagesave ne lidhje me situata ne te cilat rregulloret e aplikueshme per tatimet jane subjekt i interpretimeve, si dhe njeh provizione nese eshte e pershtatshme.

Tatimi fitimi i shtyre

Tatimi mbi fitimin i shtyre sigurohet duke perdorur metoden e detyrimit mbi diferencat e perkohshme ndermjet bazes fiskale te aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave te mbartura te tyre per qellime te raportimit financiar ne daten e raportimit. Per vitin 2011 shoqeria nuk ka llogaritur tatim fitimi te shtyre.

d) Aktive afatgjata materiale

Aktivet afagjata materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe/ose nese ka humbje te renies se vleres. Te tilla kosto perfshijne kostot e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale dhe kostove te huase per projektet afatgjata nese plotesohen kriteret e njohjes. Kur pjese te rendesishme te aktiveve afatgjata materiale nevojiten te zevendesohen ne intervale. Ne te njejten menyre, kur kryhet nje inspektim i madh, kosto e tij njihet ne vleren e mbartur te aktivit afatgjate material si nje zevendesim nese plotesohet kriteri i njohjes. Te gjitha riparimet e tjera dhe kostot e mirembajtjes njihen ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.

Toka dhe ndertesat maten me vlere te drejte minus zhvleresimin e akumuluar te ndertesave dhe njohjes se humbjeve te renies se vleres pas dates se rivleresimit. Vleresimet jane kryer per te siguruar qe vlera e drejte e nje aktivi te rivleresuar nuk ndryshon materialisht nga vlera e mbartur e tij.

Amortizimi llogaritet mbi vleren e mbetur si me poshte:

Ndertesat	5%
Instalime teknike e te pergjitheshme	20%
Makineri dhe paisje	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyre informatike	25%

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale si dhe ndonje pjese e rendesishme e njohur fillimisht, crregjistrohet me daljen jashte perdorimi te saj ose kur nuk pritet te sigurohen perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Cdo fitim apo humbje qe realizohet nga dalja jashte perdorimit e aktivit perfshihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi crregjistrohet.

e) Instrumentat financiare – njohja fillestare dhe matja ne vazhdim

i) Aktivet financiare

Njohja fillestare dhe matja

TOP CHANNEL

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

Aktivet financiare brenda objektit te SNA 39 klasifikohen si aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, huate dhe te arketueshmet, investime te mbajtura deri ne maturim, aktive financiare te disponueshme per shitje, ose si derivative te percaktuara si instrumenta mbrojtes ne nje mbrojtje efektive sic eshte e pershtatshme. Shoqeria percakton klasifikimin e aktiveve te saj financiare ne njohjen fillestare.

Te gjitha aktivet financiare njihen fillimisht me vlere te drejte plus kostot e transaksionit, pervec rasteve te aktiveve financiare te rregjistruara me vlere te drejte permes fitimit e humbjes.

Blerjet ose shitjet e aktiveve financiare qe kerkojne dorezimin e aktivit gjate nje afati kohor te percaktuar nga rregullat ose konventat e tregjeve (rruga e drejte e te marredhenieve tregtare) njihen ne daten e transaksionit, p.sh., data kur Shoqeria merr persiper te blej apo shese aktivin.

Aktivet financiare te Shoqerise perfshijne mjetet monetare, llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme, huate dhe te tjera aktive.

Matja ne vazhdim
Matja ne vazhdim e aktiveve financiare varet nga klasifikimi i tyre sic pershkruhet me poshte:

(a) Aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes
Aktivet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes perfshijne aktive financiare te mbajtura per tregtim te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes. Aktivet financiare jane klasifikuar si te mbajtura per tregtim nese jane blere me qellimin per ti shitur ose riblere ne nje afat te shkurter kohor. Derivatet, duke perfshire ketu, derivativet e perfshire te vecuar, klasifikohen gjithashtu si te mbajtura per tregtim, pervec kur jane percaktuar si instrumenta te mbrojtjes efektive sic percaktohet nga SNA 39.

Aktivet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes mbahen ne pasqyren e pozicionit financiar me vlere te drejte, me ndryshimet neto te njohura si kosto financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Aktivet financiare te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, percaktohen ne daten e njohjes fillestare dhe vetem nese permbushet kriteri i njohjes sipas SNA 39. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje aktiv financiar me vlere te drejte permes fitimit se humbjes.

(b) Huate dhe te arketueshmet
Huate dhe te arketueshmet jane aktive financiare jo-derivative me pagesa te percaktuara ose fikse dhe qe nuk jane te kuotuara ne nje treg aktiv. Pas matjes fillestare, te tilla aktive financiare maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes se interesit efektiv dhe duke zbritur renien e vleres. Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh cdo zbritje ose shtesa te blerjes dhe tarifat ose kostot qe jane pjese perberese e normes efektive te interesit. Amortizimi i normes efektive te interesit perfshihet ne te ardhurat financiare ne pasqyren e te ardhurave. Humbjet e njohura nga renia e vleres njihen ne pasqyren e te ardhurave si kosto financiare per huate dhe ne kostot e shitjes ose ne shpenzimet e tjera operative per te arketueshmet.

Shoqeria vlereson nese aftesia dhe qellimi per t'i shitur aktivet e saj financiare te disponueshme per shitje ne nje te ardhme te afert eshte akoma e mundur. Kur Shoqeria e ka te pamundur t'i tregetoje keto aktive financiare per shkak te tregjeve joaktive dhe vendimi i drejtimit ndryshon rrenjesisht ne te ardhmen e parashikueshme, Shoqeria mund te zgjedhe t'i riklasifikoje keto aktive. Riklasifikimi si hua dhe te arketueshme eshte i lejueshem kur aktivet financiare permbushin kriterin e huave dhe te arketueshmeve dhe Shoqeria ka qellimin dhe aftesine t'i mbaje keto aktive per nje te ardhme te parashikueshme ose deri ne maturim. Riklasifikimi ne kategorine e te mbajtura deri ne maturim lejohet vetem kur entiteti ka aftesine dhe qellimin t'i mbaje aktivet financiare respektivisht.

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

Instrumentat financiare – njohja fillestare dhe matja ne vazhdim (vazhdim)

Per nje aktiv financiar te riklasifikuar nga kategoria e te disponueshme per shitje, vlera e drejte e mbartur ne daten e riklasifikimit behet kostoja e saj e amortizuar dhe cdo fitim apo humbje e meparshme e ketij aktivi qe eshte njohur ne kapital amortizohet ne fitim ose humbje pergjate jetes se dobishme te mbetur te investimit duke perdorur normen efektive te interesit (NEI). Cdo diference ndermjet kostos se re te amortizuar dhe shumes ne maturim amortizohet gjithashtu mbi jeten e dobishme te mbetur te aktivit duke perdorur NEI. Nese aktivi percaktohet me pas si i rene ne vlere, atehere vlera e rregjistruar ne kapital do riklasifikohet ne pasqyren e te ardhurave.

Crregjistrimi
Nje aktiv financiar (ose ku eshte e mundur pjese e aktivit financiar apo grup aktivesh financiare te ngjashme) crregjistrohet kur:

- ✓ Te drejtat per te siguruar flukse monetare nga aktivi kane perfunduar
- ✓ Shoqeria ka transferuar te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga aktivi.

ii) Renia ne vlere e aktiveve financiare
Shoqeria vlereson ne cdo date te raportimit, nese ka evidence objektive qe nje aktiv financiar apo grup aktivesh ka pesuar renie vlere. Nje aktiv finanicar apo nje grup aktivesh financiare konsiderohet i zhvleresuar vetem nese ka evidence objektive per zhvleresimin si rezultat i nje ose me shume ngjarjeve qe kane ndodhur pas njohjes fillestare te nje aktivi (nje "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare te ardhshme te vleresuara te aktivit finanicar apo grupit te aktiveve financiare dhe qe mund te matet ne menyre te besueshme. Evidence e zhvleresimit mund te perfshije tregues qe debitoret apo grup debitoresh mund te jene duke perjetuar probleme te medha financiare, mospagesa ne kohe te principalit apo interesit, probabiliteti qe ata te kalojne ne falimentim ose nje riorganizim tjeter financiar dhe kur te dhenat e vezhgueshme tregojne se ka nje renie te matshme te flukseve monetare te ardhshme te parashikuara, te tilla si ndryshime ne fusha dhe kushtet ekonomike qe jane ne korrelacion me vonesat.

Aktivet financiare me kosto te amortizuar
Per aktivet financiare te mbajtura me kosto te amortizuar, Shoqeria fillimisht vlereson nese ka evidence objektive per zhvleresimin per aktivet financiare individualisht dhe qe jane ne menyre individuale te rendesishme, ose ne kolektiv per aktive financiare qe nuk jane individualisht te rendesishme. Nese Shoqeria percakton qe nuk ka evidence objektive per zhvleresimin per nje aktiv financiar te vleresuar individualisht, pavaresisht nese eshte i rendesishem apo jo, e perfshin aktivin ne nje grup aktivesh financiare me karakteristika rreziku krediti te ngjashem dhe i vlereson ne menyre kolektive per zhvleresim. Aktivet qe vlereson individualisht per zhvleresim dhe per te cilat ka ose do te kete nje humbje nga zhvleresimi, nuk do te perfshihen ne nje vleresim kolektiv zhvleresimi.

Investime financiare te disponueshme per shitje
Per aktivet financiare te disponueshme per shitje, Shoqeria vlereson ne cdo date raportimi nese ka evidence objektive qe nje investim apo grup investimi te jete zhvleresuar.

Letrat me vlere te kapitalit nuk rimerren nepermjet pasqyres se te ardhurave; rritjet ne vleren e drejte pas zhvleresimit njihen drejteperdrejte ne te ardhurat gjitheperfshirese.

Ne rastin e instrumentave te borxhit te klasifikuara si te disponueshme per shitje, renia e vleres vleresohet bazuar ne te njejtin kriter si aktivet financiare me kosto te amortizuar. Megjithate shuma e rregjistruar per zhvleresimin eshte humbja e akumuluar e matur si diference ndermjet kostos se amortizuar dhe vleres se drejte aktuale pakesuar me cdo humbje te renies se vleres te atij investimi te njohur me pare ne pasqyren e te ardhurave.

TOP CHANNEL

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

Instrumentat financiare – njohja fillestare dhe matja ne vazhdim (vazhdim)

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te perllogariten mbi vleren e reduktuar te mbartuar te aktivit, duke perdorur normen e interesit te perdorur per te skontuar flukset monetare te ardhshme me qellim matjen e humbjes nga renia e vleres. Te ardhurat nga interesi rregjistrohen si te ardhura financiare. Nese ne nje vit te mevonshem, vlera e drejte e nje instrumenti borxhi rritet dhe kjo rritje mund te lidhet ne menyre objektive me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes ne pasqyren e te ardhurave te humbjes nga renia e vleres, humbja nga renia e vleres rimerret nepermjet pasqyres se te ardhurave.

iii) Detyrimet financiare
Njohja fillestare dhe matja
Detyrimet financiare qe perfshihen ne qellimin e SNK 39 klasifikohen si detyrime financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, hua dhe kredi, ose si derivative te percaktuar si instrumenta mbrojtes ne nje mbrojtje efektive, si eshte me e pershtatshme. Shoqeria percakton ne njohjen fillestare klasifikimin e detyrimeve financiare te saj.

Te gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlere te drejte, plus kostot direkte te transaksionit ne rastin e huave dhe kredive.

Detyrimet financiare te Shoqerise perfshijne llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime.

Matja e mevonshme
Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre sic pershkruhet me poshte:

Detyrime financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes

Detyrimet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes perfshijne detyrimet financiare te mbajtura per tregetim dhe detyrimet financiare te percaktuara qe ne njohjen fillestare si me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes.
Detyrimet financiare klasifikohen si te mbajtura per tregetim nese jane blere me qellimin per ti shitur ne nje te ardhme te afert. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje detyrim financiar si te mbajtur per shitje. Fitimet ose humbjet ne detyrimet e mbajtura per tregetim njihen ne pasqyren e te ardhurave.

Detyrimet financiare te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, percaktohen qe ne daten e njohjes fillestare dhe vetem nese permbushet kriteri i SNK 39. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje detyrim financiar si me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes.

Huate dhe kredite
Pas njohjes fillestare, huate dhe kredite qe mbartin interes maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes efektive te interesit (NEI). Fitimet dhe humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave kur detyrimet crregjistrohen si dhe nepermjet procesit te amortizimit NEI.

Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh cdo zbritje apo mbivlere ne blerje dhe tarifat apo kostot qe jane pjese perberese e NEI. Amortizimi NEI perfshihet ne shpenzimet financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Crregjistrimi
Nje detyrim financiar crregjistrohet kur angazhimi i detyrimit shkarkohet, anullohet apo skadon.
Kur nje detyrim financiar ekzistues zevendesohet me nje tjeter nga i njejti huadhenes me terma totalisht te ndryshme, ose kur termat e nje detyrim ekzistues ndryshohen thelbesisht, nje kembim i tille apo modifikim trajtohet si crregjistrim i detyrimit origjinal dhe njohja e nje detyrimi te ri. Diferenca ne vleren e mbartur respektive njihet ne pasqyren e te ardhurave.

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

Instrumentat financiare – njohja fillestare dhe matja ne vazhdim (vazhdim)

iv) Kompensimi i instrumentave financiare
Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto raportohet ne pasqyren e pozicionit financiar nese, dhe vetem nese:

- ✓ Ka nje te drejte ligjore te detyrueshme per te kompensuar vlerat e njohura dhe,
- ✓ Ka nje qellim per te zgjidhur ceshtjen mbi bazen neto, ose te realizohet aktivi dhe te shlyhet detyrimi ne te njejten kohe

v) Vlera e drejte e instrumentave financiare
Per instrumentat financiare qe nuk tregtohen ne tregje aktive, vlera e drejte percaktohet duke perdorur teknika vleresimi te pershtatshme. Teknika te tilla mund te perfshijne:

- ✓ Perdorimin e transaksioneve aktuale me vlerat e tregut
- ✓ Referimin e vleres se drejte aktuale te nje instrumenti qe eshte thelbesisht i njejte
- ✓ Nje analize te flukseve monetare te skontuara ose modele te tjera vleresimi.

f) Inventaret
Inventaret jane vleresuar me me te voglen ndermjet kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kosto e inventareve bazohet ne metoden e kostos mesatare te ponderuar, dhe perfshin shpenzime te hasura ne blerjen e inventareve, prodhimin apo kostot e transformimit dhe shpenzime te tjera te hasura deri ne sjelljen e tyre ne kushtet dhe vendin ekzistues. Ne rastin e inventareve te prodhuar dhe punimit ne proces, kosto perfshin edhe nje pjese te pershtatshme te shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal operativ. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i shitjes i pritur ne kushtet normale te biznesit, minus kostot e pritura te perfundimit dhe shpenzimet e nevojshme te vleresuara per te kryer shitjen.

g) Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare
Shoqeria vlereson ne cdo date raportimi nese ka shenja qe tregojne qe nje aktiv mund te kete pesuar renie ne vlere (zhvleresuar). Nese ka tregues te tille, ose kur kerkohet nje testim vjetor per zhvleresimin e nje aktivi, Shoqeria vlereson shumen e rekuperueshme te aktivit. Shuma e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e larta ndermjet vleres se drejte minus kostot e shitjes se aktivit apo njesise gjeneruese te parase (NGP) dhe vleres ne perdorim te saj dhe percaktohet per nje aktiv te vecante, pervec kur aktivi nuk gjeneron te hyra monetare qe jane thelbesisht te pavarura nga ato te aktiveve te tjera apo grupeve te aktiveve. Kur vlera e mbartur e nje aktivi ose NGP tejkalon vleren e rikuperueshme, aktivi konsiderohet i zhvleresuar dhe pakesohet deri ne vleren e rikuperueshme te tij. Ne percaktimin e vleres ne perdorim, flukset monetare te vleresuara skontohen ne vleren aktuale duke perdorur nje norme skontimi para tatimit qe reflekton vleresimin aktual te tregut te vleres ne kohe te parase dhe risqet specifike te aktivit. Ne percaktimin e vleres se drejte minus kostot e shitjes, meren ne konsiderate transaksione tregu me te fundit, nese jane te disponueshme. Nese transaksione te tilla nuk mund te identifikohen, perdoret nje model vleresimi i pershtatshem. Keto llogaritje vertetohen nga perberes te vleresimit, cmimet e aksioneve te kuotuara per filiale te tregetuara publikisht ose tregues te tjere te vleres se drejte te gatshem.

Humbjet nga renia e vleres prej operacioneve te vazhdueshme, duke perfshire zhvleresimin e inventareve njihen ne pasqyren e te ardhurave ne kategorite e shpenzimeve ne perputhje me funksionin e aktivit te zhvleresuar, pervec aktiveve afatgjata materiale te rivleresuara me pare dhe rivleresimi eshte kaluar ne te ardhurat e tjera gjitheperfshirese. Ne kete rast, renia e vleres njihet gjithashtu ne te ardhurat e tjera gjitheperfshirese deri ne masen e rivleresimit te meparshem.

TOP CHANNEL

Per aktivet duke perjashtuar emrin e mire, vleresimi behet cdo date raportimi nese ka tregues qe humbje te renies se vleres te njohura me pare mund te mos ekzistojne me ose mund te jene pakesuar. Nese ekzistojne tregues te tille, Shoqeria vlereson shumen e rikuperueshme te aktivit apo NGP. Nje humbje e renies se vleres e njhur me pare rimerret vetem nese ka pasur ndryshime ne supozimet e perdorura per te percaktuar vleren e rikuperueshme te aktivit qe prej humbjes se renies se vleres te fundit te njohur. Rimarrja kufizohet deri ne masen qe vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vleren e rikuperueshme, si dhe nuk tejkalon vleren e mbartur qe do te ishte percaktuar, neto nga amortizimi nese humbja nga renia e vleres nuk do te ishte njohur per aktivin ne vitet e kaluara. Nje rimarrje e tille njihet ne pasqyren e te ardhurave, pervec kur aktivi mbahet me kosto te rivleresuar , ne kete rast rimarrja do te trajtohet si nje rritje e rivleresimit.

h) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne pasqyren e pozicionit financiar perfshijne mjetet monetare ne banke dhe ne arke dhe me nje maturitet prej 3 apo me pak muajsh.
Per qellime te pasqyres se flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsistojne ne mjete monetare dhe sic percaktohet me siper.

i) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqeria njeh si detyrim vleren e paskontuar te kostove te cmuara lidhur me lejen vjetore te pritshme per tu paguar ne kembim te sherbimit te punonjesit per periudhen e perfunduar.

j) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

k) Angazhime dhe detyrime te mundshme

Detyrimet e mundshme nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbartin perfitime ekonomike. Nje aktiv i mundshem nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlera e nje humbje te mundshme njihet si provizion nese ka mundesi qe ngjarje te ardhshme do te konfirmohen, nje detyrim do te haset ne daten e pasqyres se pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes.

l) Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter. Per qellim te shpalosjes ne pasqyrat financiare, vetem ortaku i Shoqerise do te konsiderohet pale e lidhur.

m) Ngjarje pas dates se bilancit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese per pozicionin e Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.

TOP CHANNEL

2.3 Ndryshimet ne politikat dhe shpalosjet kontabel

(a) Standarte te reja dhe te amenduara dhe interpretime te adoptuara nga Shoqeria

Standartet e reja dhe amendimet e standarteve qe paraqiten me poshte jane te detyrueshme per here te pare per vitin financiar qe fillon me 1 Janar 2011:

SNK 24 Transaksionet me Palet e Lidhura (amendim)

BSNK ka publikuar nje amendim te SNK 24 qe sqaron perkufizimin e nje pale te lidhur. Perkufizimet e reja theksojne nje pikepamje simetrike te marredhenies ndermjet paleve te lidhura dhe sqaron rrethanat ne te cilat persona dhe personeli manaxherial baze ndikojne ne marredheniet ndermjet paleve te lidhura te entitetit. Si rrjedhoje amendimi paraqet nje perjashtim nga kerkesat e shenimeve shpjeguese te pergjithshme per palet e lidhura per transaksione me qeverine dhe entitete te cilat jane te kontrolluara, ne kontroll te perbashket ose influence te rendesishme nga e njejta qeveri si ajo e entitetit raportues.

(b) Standarte, amendime dhe interpretime te standarteve ekzistues efektive ne 2011 por jo relevante per Shoqerine

